

Banka të siguruar



ProCredit Bank



Emporiki Bank



Veneto Banca



Credins Bank



Banka Kombëtare Tregtare



Alpha Bank



Intesa Sanpaolo Bank



Union Bank



Raiffeisen Bank



Banka Ndërkombëtare Tregtare



Banka e Bashkuar e Shqipërisë



Banka e Kreditit të Shqipërisë



NBG Bank



First Investment Bank



SOCIETE GENERALE GROUP

Banka Juaj dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave gjatë përmbushjes së misionit të tyre konvergojnë në të njëjtin qëllim për siguri dhe stabilitet të sistemit bankar.

I NDERUAR PUNONJËS I BANKËS !

Profesionalizmi Juaj është kontribut në rritjen e besimit të qytetarit ndaj **Bankës Suaj!**



Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit (pallati pranë Ambasadës
Amerikane), Nr.317, Tiranë
Tel.: +355 4 2347298
www.dia.org.al

Që Banka Juaj të jetë sa më e sigurt dhe e shëndetshme, nevojitet dhe një sistem bankar e financiar sa më i stabilizuar.

Në përbushje të këtij misioni të rëndësishëm funksionon edhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave, që ka si qëllim sigurimin dhe kompensimin e depozitave në përputhje me ligjin nr 8873 datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” dhe ndryshimeve të tij me ligjin nr. 10106, datë 30.03.2009. “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

JU, punonjës i bankës, me punën dhe kontributin Tuaj, jeni një hallkë e rëndësishme në bashkëpunimin Bankë - ASD

Në kontaktin Tuaj të parë profesional me depozituesin, informoni me korrektesë **KLIENTIN TUAJ**

- Të sigurosh depozitat do të thotë:
 - të rritësh sigurinë e qytetarëve ndaj bankës
 - të mbrosh kursimet e qytetarëve nga rreziku i një falimentimi të mundshëm të bankave
 - të sigurosh kompensimin e pjesës më të madhe të depozituesve të një banke që falimenton
- Depozita të siguruar janë :
 - Të gjitha llojet e produktit depozitë për klientët individë që mbajnë kursimet e tyre në bankat që liçensohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e aktivitetit bankar.
- Shuma e siguruar është deri në **2.500.000 lekë**

Është e rëndësishme të dini se regjistrimi i saktë i të dhënave mbi depozituesin

- lehtëson punën tuaj për identifikimin korrekt të depozitës dhe të depozituesit të Bankës Suaj.
- përbën bazën e të dhënave për krijimin e regjistrimit të depozituesve të bankës, si dokument bazë, për llogaritjen e primit të sigurimit nga Banka Juaj, si dhe për procesin e sigurimit e kompensimit të depozitave.

A e dini se të njohësh klientin sipas politikave të Bankës Suaj, veç të tjerash do të thotë që:

- Të komunikosh me transparencë me klientin e bankës
- Të administrosh në bankë, të identifikosh, kontrollosh dhe verifikosh të dhënat e identifikimit të klientit që ndodhet përballë Jush.
- Të përjashtosh mundësinë e krijimit të më shumë se një numri personal identifikimi në Bankën Tuaj për të njëjtin klient.

BANI MEND: NJË KLIENT, NJË NUMËR UNIK TË NRP

- Ai është elementi bazë në saktësinë e agregimit dhe netimit të shumës së depozitave për të njëjtin depozitues (klient) në Bankën Tuaj.

KUJDES!

- Ja cilat janë të dhënat minimale të detyrueshme për t’u regjistruar në Bankë, me qëllim identifikimin e klientit/depozituesit Tuaj:

1. **Emër**
2. **mbiemër**
3. **atësia**
4. **numër dokumenti identifikimi**
5. **adresa**
6. **numri i telefonit**

- Për çdo depozitues regjistroni me kujdes, pasqyroni saktë dhe në kohë çdo njoftim që depozituesi bën në bankë, lidhur me ndryshimin e të dhënave të mësipërme.
- Administroni një kopje të dokumentit të identifikimit të depozituesit në Bankën Tuaj
- Depozitoni nënshkrimin/firmën e depozituesit në Bankën Tuaj

VINI RE !

Çdo neglizhencë lidhur me veprimet e mësipërme, shkakton mos zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 8873 datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” dhe ndryshimeve të tij sipas ligjit nr. 10106, datë 30.03.2009. “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.